



KOORDINATORI KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT

RAPORT
MONITORIMI PËR PERIUDHËN
JANAR-MARS 2022

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE
KUNDËR KORRUPSIONIT 2015 – 2023

www.drejtesia.gov.al

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJJE

- *Përmbledhje ekzekutive mbi progresin e zbatimit të planit të veprimit për janar-mars 2021*
- *Realizimi i rekomandimeve të lëna për zbatim në raportin vjetor 2020*
- *Metodologjia e hartimit të raportit të monitorimit*
- *Matrica e riskut*
- *Konsultimi publik*

PROGRESI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT

- *Masa dhe aktivitete të implementuara me sukses në periudhën përkatëse*
- *Statusi i masave dhe aktiviteteve që kanë realizuar qëllimet e politikave (Qasjet)*
- *Statusi i aktiviteteve që kanë realizuar qëllimet e politikave (Qasjet)*
- *Statusi i masave që kanë realizuar qëllimet e politikave (Qasjet)*
- *Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur masat dhe aktivitetet*
- *Histori suksesi (përmes masave priritare)*

EKZEKUTIMI I BUXHETIT

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- *Rekomandime*
- *Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit*
- *Vlerësimi i riskut duke përdorur masat dhe aktivitetet*
- *Hapat e rradhës*

LISTA E SHKURTIMEVE

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
ADB	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
ASHSGJ	Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor
ATP	Agjencia e Trajtimit të Pronave
AZHBR	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPSHP	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
DVP	Drejtoria Vendore e Policisë
GTA	Grupi Tematik për Antikorrupsionin
ILDKPKI	Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
IML	Instituti i Mjeksisë Ligjore
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KKK	Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KSHB	Komiteti Shqiptar i Birësimit
KSHZ	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MK	Ministria e Kulturës
MM	Ministria e Mbrojtjes
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PV	Plani i Veprimit
QBZ	Qendra e Botimeve Zyrtare
SNKK	Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit

SPAK
SHÇBA
SHKBB
VKM

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat
Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve
Vendim i Këshillit të Ministrave

DRAFT

HYRJE

Korrupsioni është një kërcënim për demokracinë, mirëqeverisjen, konkurrencën e ndershme, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe politik të një vendi. Ai pengon rëndë zhvillimin ekonomik, duke krijuar një sistem pabarazie, paragjykimi e nepotizmi, duke shkatërruar besimin e njerëzve tek shteti i tyre, prandaj lufta kundër korrupsionit është sot një nga sfidat parësore të çdo shteti me kulturë demokratike, vizion dhe integritet të lartë. Qeveria ka dhe do vazhdojë në mënyrë të pandalur të ketë një vullnet të palëkundur në luftën kundër korrupsionit, përmes aksioneve parandaluese, masave ndëshkuese dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese.

Përparësia e qeverisë në fushën e luftës kundër korrupsionit, përkon më së miri me kushtëzimet e vendosura nga Bashkimi Evropian për hapjen e negociatave për anëtarësimin në BE. Lufta kundër korrupsionit është një ndër pesë politikat të cilat vendi ynë këshillohet t'i ndjekë me përparësi në procesin e integritet evropian të vendit. Po kështu, parandalimi dhe ndëshkimi i korrupsionit është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentat ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, etj.

Prej vitit 2015 Shqipëria ndjek dhe zbaton Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit. Me Vendimin nr. 516, datë 1.7.2020 të Këshillit të Ministrave afati i zbatimit të SNKK u zgjat deri në vitin 2023. Vizioni i SNKK-së 2015-2023 është: *“Institucione shqiptare transparente dhe me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe garantojnë shërbim cilësor dhe të pakorrruptueshëm”*. Qëllimet madhore politikës së Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit janë parandalimi, ndëshkimi dhe ndërgjegjësimi/edukimi rreth korrupsionit. Këto qëllime politikash (qasje) janë afatgjata dhe shtrihen përgjatë kohës së zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit.

Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2023, përmban 18 objektiva specifike, të cilët janë:

Parandalim:

A.1 Rritja e transparencës në Veprimtarinë Shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion

A.2 Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike

A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike

A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit

A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave

A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike

A.7 Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut

A.8 Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion

A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë

A.10 Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit

A.11 Adoptimi i politikave anti-korrupsion në nivelin e qeverisjes vendore

Ndëshkim:

B.1 Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit

B.2 Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit

B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar

B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit.

Ndërgjegjësim:

C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit

C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit

C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile.

Përmbledhje ekzekutive mbi progresin e zbatimit të planit të veprimit për janar-mars 2022

Plani i Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2023, parashikon masa dhe aktivitete specifike që duhen të realizohen për përmbushjen e këtyre objektivave, sipas afateve të detajuara në të.

Ky raport monitorimi, *janar – mars 2022*, paraqet vetëm realizimin e masave dhe aktiviteteve (produkteve) të Planit të Veprimit. Raporti identifikon progresin dhe ecurinë e zbatimit të masave për këtë periudhë monitorimi, duke marrë në konsideratë dhe vlerësim realizimin e tyre, shkallën e performancës së aktiviteteve të institucioneve që raportojnë aktiviteteve dhe masa në proces zbatimi dhe uljen e numrit të masave të pazbatuara.

Raporti identifikon arritjen e rekomandimeve dhe hapat për zbatimin e tyre, referuar rekomandimeve të lëna në raportin vjetor të monitorimit 2021. Në këtë analizë ofrohet gjithashtu informacioni për të parë relevancën e përmbajtjes së këtij plani veprimi përkundrejt arritjes së indikatorëve të parashikuar në Pasaportën e Indikatorëve, të objektivëve specifike dhe të qëllimit madhor, atë të arritjes së qëllimeve të politikave (qasjeve) të Strategjisë, parandalim – ndëshkim – ndërgjegjësim.

Ky raport krijon dhe vendos të gjithë infrastrukturën analitike që rekomandimet e lëna të trajtohen në raportet pasardhës.

Për këtë periudhë monitorimi, *janar - mars 2022*, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna për 58 masa e 108 aktivitete, të shpërndara përkatësisht në 29 masa e 58 aktivitete për qasjen parandaluese (A), 20 masa e 29 aktivitete për qasjen ndëshkuese (B) dhe 9 masa e 21 aktivitete për qasjen ndërgjegjësuere (C).

Përmes zbatimit të Planit të Veprimit për periudhën *janar – mars 2022*, janë zbatuar plotësisht 34 masa, pjesërisht 15 masa dhe nuk janë zbatuar 9 masa si dhe janë zbatuar plotësisht 64 aktivitete, pjesërisht 11 aktivitete dhe të pazbatuara janë 33 aktivitete.

Në vijim paraqitet realizueshmëria e objektivëve të strategjisë sipas shkallës së realizimit të masave dhe aktiviteteve:

	Objektivat	Shkalla e realizimit sipas masave
Parandalimi	A.1 Rritja e transparencës në Veprimtarinë Shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion	86 në 110 për qind e masave të zbatuara
	A.2 Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
	A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike	86 në 110 për qind e masave të zbatuara
	A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
	A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave	86 në 110 për qind e masave të zbatuara
	A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
	A.7 Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
	A.8 Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion	86 në 110 për qind e masave të zbatuara
	A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë	86 në 110 për qind e masave të zbatuara
	A.10 Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit	86 në 110 për qind e masave të zbatuara
	A.11 Adaptimi i politikave anti-korrupsion në nivelin e qeverisjes vendore	51 në 85 për qind e masave të zbatuara

Ndëshkimi	B.1 Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit	86 në 110 për qind e masave të zbatuara
	B.2 Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndërkohëzimin penal të korrupsionit	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
	B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar	— ¹
	B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit	51 në 85 për qind e masave të zbatuara
Ndërgjegjësimi	C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit	86 në 110 për qind e masave të zbatuara
	C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit	86 në 110 për qind e masave të zbatuara
	C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile.	0 deri në 30 për qind e masave të zbatuara

Për këtë periudhë *janar – mars 2022*, janë shënuar arritje në qëllimet e politikës (qasjen) parandaluese (A), ndëshkuese (B) dhe ndërgjegjësuere (C) të zbatimit të strategjisë, më konkretisht përmendim:

1. Zyra e Komisionerit ka monitoruar në 3M1 2022, ¼ e autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë. Në total janë monitoruar 100 nga 313 autoritete publike dhe 16 nga 61 Njësi të Vetëqeverisjes Vendore. Poashtu regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve është instaluar në 25 autoritete publike duke e çuar numrin total të autoriteteve publike që kanë instaluar regjistrin elektronik në 120 autoritete dhe duke arritur vlerën e synuar vjetore që në këtë tre-mujor të vitit.
2. AKSHI ka vijuar punën për shtimin e shërbimeve elektronike dhe përmirësimin e shërbimeve ekzistuese në portalin unik qeveritar e-Albania. Është rritur edhe numri i sistemeve të lidhura me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit. Në portalin e-Albania ofrohen aktualisht, 1 225 shërbime elektronike deri në fund të marsit 2022.
3. Instrumentet e integritetit janë hartuar dhe miratuar në institucionet e qeverisjes qendrore. Ministria e Brendshme, Ministria e Financës dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë kanë miratuar planet e integritetit, ndërkohë që procesi i vlerësimit të riskut të integritetit ka përfunduar në të gjitha ministrinë e tjera.
4. Planet e Integritetit kanë vijuar miratimet edhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Bashkitë e Beratit, Bulqizës, Belshit, Përmetit dhe Pogradecit kanë miratuar planet me vendim të Këshillit Bashkiak dhe vijon vlerësimi i risqeve në bashkitë e Has, Pukë, Kavajë, Kukës, Himarë.

¹ Ky objektivi nuk është matur pasi e fillon zbatimin në tremujorët e tjerë të 2022.

5. Është kryer përpunimi dhe harmonizimi i të dhënave statistikore, statistikat e konsoliduara për veprat penale (Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, SPAK dhe Gjykatat) referuar 6M 2 dhe vjetore 2021. Gjithashtu, janë mbledhur të dhënat për asetet e konfiskuara, për veprat penale në lidhje me korrupsionin për 6M 2 dhe vjetore 2021.
6. Hetimet dhe operacionet e përbashkëta ndërmjet PSh – SHÇBA-SPAK kanë finalizuar Operacionin “Pika 2”. Nga hetimi proaktiv i kryer u dokumentuan veprimeve korruptive të punonjësve të policisë dhe u caktuan nga Gjykata e Posaçme, masat e sigurisë “arrest në burg” për 16 punonjës policie “arrest në shtëpi” për 12 punonjës dhe 2 shtetas dhe “pezullim nga detyra” për 4 punonjës policie.
7. Në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm janë regjistruar 48 procedime penale për veprat penale në fushën e korrupsionit. Janë dërguar për gjykim 28 procedime me 30 të pandehur, nga të cilët janë dënuar nga gjykata 11 të pandehur.
Për këtë periudhë raportimi, në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm janë kryer hetime proaktive dhe/ose me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit në 19 procedime penale për veprat penale të korrupsionit dhe që lidhen me detyrën ose me rritje 111 % krahasuar me 3 mujorin 2021, dhe që zënë 39,58 % të procedimeve të regjistruara për këtë grupvepër penale.
8. Pranë AMP (ish-SHÇBA) nëpërmjet linjës së gjelbër janë marrë 1114 telefonata, nga të cilat 566 telefonata kanë qenë brenda objektit të punës së SHÇBA-së; 167 telefonata kanë qenë jashtë fushës së veprimtarisë së SHÇBA-së; 381 telefonata kanë qenë me objekt informacion në lidhje me veprimtarinë e SHÇBA-së. Janë administruar 479 ankesa të ardhura pranë Shërbimi. Në përfundim të hetimeve, në 6 raste është sugjeruar fillimi i hetimit disiplinor nga Drejtoria e Standardeve Profesionale, në Policinë e Shtetit, për 12 punonjës policie, nga të cilët 3 punonjës të nivelit parë drejtues e 9 punonjës të nivelit zbatues.
9. KQZ ka miratuar aktet dhe udhëzuesit për mënyrën e raportimit financiar gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore përmes vendimit Nr.13, datë 04.02.2022; janë përcaktuar rregullat për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.
10. Për këtë periudhë raportimi, MFE ka realizuar 7 vlerësime të jashtme të cilësisë, nga një total prej 25 vlerësimesh të parashikuara për vitin 2022.
11. Policia e Shtetit ka trajtuar dhe shkëmbyer 104 praktika me Interpolin nga të cilat: 68 praktika nga sektori e Krimit Ekonomik Financiar dhe 34 praktika nga Sektori për Pastrimin e Parave dhe Aseteve Kriminale; 77 praktika me EUROPOL-in, nga të cilat 38 nga sektori për krimin ekonomik e financiar dhe 39 nga sektori për pastrimin e parave, 32 praktika me Departamentin e Mardhënieve Ndërkombëtare nga sektori për krimin ekonomik e financiar dhe 15 praktika me rrjetin CARIN.
12. Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion ka paraqitur/referuar pranë organit të prokurorisë 7 kallëzime penale, për 19 persona. Nga këta, 2 kallëzime penale, për Drejtorinë e

Përgjithshme të Gjendjes Civile, ku janë kallëzuar penalisht 4 persona; 1 kallëzim penal, për Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, ku janë kallëzuar penalisht 3 persona; 3 kallëzime penale, për DVASHK Sarandë, ku janë kallëzuar penalisht 7 persona + persona të tjerë të paidentifikuar; 1 kallëzim penal, për DVASHK Pogradec (Komuna Hudenisht), ku janë kallëzuar penalisht 5 persona + anëtarët e KRRT të Bashkive/Komunave (të paidentifikuar).

13. Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion ka finalizuar 11 raporte përfundimtare hetimi të përfunduara për hetimet administrative të zhvilluara pranë institucioneve të ndryshme të rrejtit, ku janë propozuar 64 masa disiplinore, për 64 persona (punojës/nëpunës), të institucioneve, subjekt hetimi. Nga këta, 1 Raport hetimi administrativ, për DVASHK Durrës, ku janë propozuar 14 masa disiplinore; 2 Raporte hetimi administrativ, për DPGJC, ku janë propozuar 3 masa disiplinore; 1 Raport hetimi administrativ, për Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, ku janë propozuar 3 masa disiplinore; 1 Raport hetimi administrativ, për AKZM, ku janë propozuar 3 masa disiplinore; 1 Raport hetimi administrativ, për DVASHK Tirana Rurale 1, ku janë lënë rekomandime për institucionin; 1 Raport hetimi administrativ, për AKM (Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë), ku janë propozuar 2 masa disiplinore; 1 Raport hetimi administrativ, për DRAP Fier, ku janë propozuar 20 masa disiplinore; 1 Raport hetimi administrativ, për Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier, ku janë propozuar 6 masa disiplinore; 1 Raport hetimi administrativ, për DVASHK Sarandë, ku janë propozuar 10 masa disiplinore; 1 Raport hetimi administrativ, për IKMT Durrës, ku janë propozuar 3 masa disiplinore;
14. Ministria e Drejtësisë ka vijuar intensivisht aktivitetet dhe programimin në fushën e ndërgjegjësimit publik kundër korrupsionit. Është publikuar udhëzuesi “Antikorrupsioni”, një instrument ndërgjegjësimi dhe informimi i luftës kundër korrupsionit i përgatitur në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, që pëmban të gjithë informacionin e nevojshëm për çdo qytetar shqiptar por edhe të huaj që jeton dhe punon në Shqipëri. Botimi gjendet i publikuar në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë, në këtë link: <https://drejtesia.gov.al/viti-2022/> Ministria e Drejtësisë filloi gjithashtu zbatimin në shkollat të projektit të Kurrikulës Antikorrupsion në shkollat e nivelit të arsimit të mesëm të lartë, Tiranë. Kjo iniciativë e Ministrisë së Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe me mbështetjen e Ambasadës së Italisë në Tiranë, ka zhvilluar takimesh në shkollat “Petro Nini Luarasi”, “Asim Vokshi”, “Myslym Keta” dhe “Qemal Stafa”, u trajtua kuptimi i korrupsionit, mekanizmat e luftës antikorrupsion, instrumentat që qytetarët mund të përdorin për të denoncuar korrupsionin si dhe aktivizimi i të rinjve kundër korrupsionit.
15. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqëverisje ka organizuar dhe kryer takime sistematike në qarqe të vendit për ndërgjegjësimin e qytetarëve për të përdorur mjetet e komunikimit masiv për të raportuar dhe përcjellë ankesa/kërkesa, denoncime dhe nisma të tjera në përmirësim të ndërveprimit të luftës kundër korrupsionit.

16. Rrjeti i pikave të kontaktit antikorrupsion, përgjatë datave 25 dhe 26 janar 2022, zhvilloi një workshop dy-ditor me temë: “Shkrimi i politikave”. Stafi i politikave antikorrupsion pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe specialistët e institucioneve qendrore thelluan njohuritë e tyre në çështje specifike si llojet e ndryshme të hulumtimit të politikave.
17. Ministri i Drejtësisë në ushtrim të rolit të tij të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit zhvilloi takimin e posaçëm vjetor me të gjithë partnerët dhe donatorët e fushës antikorrupsion, në datën 22.02.2022, i aksesueshëm në linkun: <https://www.facebook.com/manjaulsi/posts/344322517704153>
Përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë, të ambasadës së SHBA-së, të të gjithë ambasadave në Tiranë, organizata ndërkombëtare dhe vendase, shprehën angazhimin për të vijuar mbështetjet teknike e logjistike në luftën kundër korrupsionit.
18. Ministria e Drejtësisë filloi procesin e hartimit të strategjisë së re antikorrupsion, nën drejtimin e zëvendësministrit të Drejtësisë. Reforma e politikave antikorrupsion do të përfshijë hartimin dhe konceptimin e kuadrit të plotë strategjikë (strategji - plan veprimi - pasaportë të treguesve) me impakt forcimin dhe rritjen e performancës institucionale dhe ndërinstitucionale të fushës. Strategjia e re antikorrupsion, do të ketë një parashikim kohor zbatimi vitet 2023-2030, dhe do të ofrojë një ndërthurje të qasjes horizontale antikorrupsion me sektorë specifikë, që kanë rezultuar problematike dhe me perceptimin më të lartë të korrupsionit, siç janë: arsimit-shëndetësia-pronat-taksat e tatimet.

Realizimi i rekomandimeve të lëna për zbatim në raportin vjetor 2021

Për këtë periudhë *janar – mars 2022*, ka një ecuri dhe përmirësim në kryerjen e masave dhe aktiviteteve me qëllim plotësimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e mëparshëm të monitorimit (vjetor 2021), ku përmendim përkatësisht objektivet A5, A8, A9 dhe A11. Përkatësisht, ka filluar nga funksionimi deklarimi i plotë online i pasurie dhe konfliktit të interesit të subjekteve deklarues.

Mbetet sfidë moszbatimi i disa prej masave dhe aktiviteteve në objektivat A7, B2 dhe C3 (dhe ose për të cilat raportimi nuk është arritur të mblidhet i plotë).

Krahasuar me periudhën janar - mars 2021 të monitorimit, ka një ecuri zbatimi, dhe kryesisht në masa dhe aktivitete të parashikuara për objektive në të tre qëllimet e politikave (qasje) të SNKK, parandaluese – ndëshkuese – ndërgjegjësuere.

Objektivi A1 vijon të ketë një shkallë realizueshmërie shumë të mirë, me numrin e autoriteteve publike që kanë vendosur e-regjistrin e kërkesave dhe ankesave në kuadër të të drejtës së informimit (25 autoritete të rinj të shtuar këtë 3-mujor); objektivi A3 vijon të ketë një shkallë realizueshmërie shumë të mirë, me 12 e-shërbime të shtuara në këtë 3-mujor të parë të vitit duke realizuar kështu (tejkalar) vlerën e synuar për vitin 2022; në objektivet A8, A9 dhe A11 janë përmirësuar zbatimi i masave dhe aktiviteteve krahasueshmërisht me periudhën e kaluar 2021; vizibiliteti dhe ndërgjegjësimi i publikut në luftë kundër korrupsionit është i shtuar me përpjekje për marrëveshje bashkëpunimi me partnerë të fushave të ndryshme; transparenca dhe publikimi i akteve të KKK paraqitet nivele shumë të mira.

Për këtë periudhë raportimi vijojnë të adresohen si sfidë kryesore në zbatimin e planit të veprimit, çështje si:

- çështje që lidhen me komunikimin dhe informimin, proceset operacionale dhe sistemet;
 - çështje të tjera që lidhen me mjedisin rregullativ të brendshëm;
 - çështje që lidhen me komunikimin, informimin dhe bashkëpunimin ndërinsitucional në përgjithësi;
 - çështje të tjera që lidhen me kapacitetet administrative,
- faktorë këto që kanë patur ndikimin e tyre në ecurinë e deritanishme të zbatueshmërisë së masave dhe aktiviteteve të planifikuara në Planin e Veprimit.

1.1 Metodologjia e monitorimit

1.1.1 Koordinimi institucional për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.618, datë 20.10.2021 dhe Urdhrit të Kryeministrit Nr.128, datë 08.11.2021, është miratuar struktura dhe organika e Ministrisë së Drejtësisë dhe është ngritur Sektori i Planifikimit dhe Monitorimit Strategjik në Fushën Antikorrupsion, pranë Drejtorisë së Programeve dhe Projekteve Antikorrupsion, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues dhe për hartimin e raporteve periodike të monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2015 - 2023.

Ministria e Drejtësisë kryen koordinimin dhe organizimin e takimeve me të gjitha institucionet kontribuese, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Raporti i monitorimit të dokumentit strategjik (SNKK) për periudhën 1 janar deri më 31 mars 2022 është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga institucionet përgjegjëse dhe kontributore të planit të veprimit.

1.1.2 Periodiciteti i hartimit të Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Ministria e Drejtësisë do të hartojë raporte tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike, të cilët do të prodhojnë informacion të nevojshëm dhe në kohë për politikëbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në planin e veprimit të SNKK-së edhe për vitin e ardhshëm.

1.1.3 Manuali i Raportimit sipas sistemit IPSIS

Ministria e Drejtësisë do të hartojë raportin e monitorimit dhe të performancës për periudhën përkatëse sipas manualit të hedhjes së të dhënave në sistemin IPSIS. Sipas këtij dokumenti strategjik, secili institucion raporton mbi nivelin e zbatimit të çdo objektiwi dhe mase, mbi buxhetin e caktuar, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në përgjithësi. Bashkërendimi për respektimin e manualit të hedhjes së të dhënave në sistemin IPSIS do të kryhet me Agjencinë SASPAC.

1.1.4 Përputhshmëria e raporteve të monitorimit dhe performancës me parimet e Mirëqeverisjes

Ministria e Drejtësisë do të hartojë raportin e monitorimit dhe të performancës për periudhën përkatëse në përputhje me parimet e mirëqeverisjes.

Parimet e Mirëqeverisjes përmbajnë një kornizë të vlerësimit të Raporteve të Monitorimit dhe të Performancës e cila mundëson analizën e rregullt të progresit të arritur në zbatimin e Parimeve dhe caktimin e standardeve që duhet të përmbush vendi.

Parimet janë të hartuara për vendet që duan të anëtarësohen në BE dhe që marrin ndihmë nga BE-ja përmes Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA). Kushtet e acquis, si dhe direktivat dhe udhëzimet e tjera të BE-së, janë thelbi i Parimeve në fushat ku ekzistojnë acquis. Në fushat e tjera, parimet rrjedhin nga standardet dhe kërkesat ndërkombëtare, si dhe nga praktikatat e mira në shtetet anëtare të BE-së dhe në vendet e OECD-së. Si standard minimal për një administratë të mirë të orientuar drejt performancës, vendet duhet të sigurojnë respektimin e këtyre parimeve themelore. Bashkëndimi për vlerësimin e raportit të monitorimit² dhe të performancës lidhur me përmbushjen e këtyre parimeve do të kryhet me Njësinë e Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri.

1.1.5 Mekanizimi i Integruar i Politikave

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.157, datë 22.10.2018 *“Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e Mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”*, janë krijuar 8 Grupe Tematike, të cilat janë pjesë e Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik. Konkretisht, për Ministrinë e Drejtësisë është ngritur Grupi Tematik Antikorrupsion (GTA).³

GMIP do të sigurojë një strukturë të menaxhimit të nivelit të lartë, lidhur me:

- vendimmarrjen politike dhe menaxheriale të nivelit të lartë në planifikimin dhe monitorimin e reformave sektoriale, politikave dhe kuadrin strategjik;
- koordinimin e planifikimit, programimit dhe monitorimit për sektorët e përfshirë, nëpërmjet organizimit të dialogut të rregullt me partnerët për zhvillim;
- ofrimin e mbështetjes në kuadrin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;
- dialogun qeveritar mbi politikatat me partnerët për zhvillim, qeverisjen vendore, shoqërinë civile dhe sektorin privat, zbatimin e masave brenda fushës dhe sektorëve përkatës dhe promovimin dhe mbështetjen e iniciativave të koordinuara.

1.1.6 Fazat për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Fazat që do të ndiqen për përgatitjen dhe konsolidimin e raportimit dhe monitorimit të performancës, paraqiten si më poshtë:

² Para se raporti i monitorimit dhe performancës të aprovet në strukturat vendimmarrëse

³ Këtë rol e luan Komiteti Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit.

Faza 1: dërgimi i kërkesës për kontribut në datën 4 prill 2022 për të gjitha institucionet raportuese dhe konsolidimi i paketës në përputhje me standardet e sistemit IPSIS dhe Parimet e Mirëqeverisjes;

Faza 2: dërgimi i paketës së plotë për vlerësim më datë _05.2022 pranë Njesisë e Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri për vlerësim të raportit të performancës në përputhje me parimet e mirëqeverisjes.

Faza 3: konsolidimi i paketës pas marrjes dhe reflektimit të komenteve të sjella nga Njësia e Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri;

Faza 4: organizimi i mbledhjes së GTA-së më datë _05.2022 për konsultimin e paketës së konsoliduar, marrjen e komenteve nga aktorët, si dhe miratimi i tij;

Faza 5: reflektimi i komenteve dhe finalizimi i paketës së raportit të monitorimit dhe performancës;

Faza 6: publikimi i raportit 3 muajor në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë;

Faza 7: dërgimi i procedurave (minutat e takimit, konkluzionet operationale, raporti i konsultimit publik) të mbledhjes së GTA-së dhe paketa finale, së bashku me linkun për njohje Njesisë së Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri.

Faza 8: dërgimi i procedurave (minutat e takimit, konkluzionet operationale, raporti i konsultimit publik) të mbledhjes së GTA-së dhe paketa finale, së bashku me linkun për njohje Agjencisë SASPAC.

1.1.7 Parimet e Mirëqeverisjes që do të merren në konsideratë për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Raporti i Monitorimit dhe Performancës do të zbatohet parimet e mirëqeverisjes që do të duhet të ndiqen në zbatimin e një sistemi të mirë dhe efektiv të M & R-së:

- **EFIKASITETI:** Agregimi i niveleve të dokumenteve. Ky parim duhet të lejojë shfrytëzimin e sinergjive mes raporteve të dokumenteve të ndryshme. Nëse dokumentet janë të lidhura ngushtë në aspektin e përmbajtjes, atëherë sistemi i M & R-së duhet ta marrë këtë parasysh për të mundësuar zhvillimin e mëtejshëm të njëri-tjetrit dhe jo mbivendosjen e njëri-tjetrit. Elementet bazë të raporteve të M & R-së (p.sh. objektivat, aktivitetet, indikatorët) në dokumentin e nivelit më të ulët do të zhvillohen drejt përmbajtjes së M & R-së në dokumentet e nivelit në të lartë. Duhet të merren parasysh lidhjet. Ky parim duhet të përmirësojë frekuencën dhe përmbajtjen e raporteve të M & R-së.
- **LLOGARIDHËNIA:** Respektimi i përmbajtjes së dokumenteve të planifikimit. Raportet e monitorimit duhet të përqendrohen në elementet e dokumenteve të planifikimit për të siguruar llogaridhënie lidhur me reformat dhe ndërhyrjet e planifikuara.
- **RËNDËSIA:** Respektimi i nevojave të përdoruesve të monitorimit dhe performancës. Raportet e M & R-së duhet të jenë të përshtatura për nevojat e përdoruesit në aspektin e përmbajtjes, gjatësisë dhe frekuencës. Për më tepër, raportet duhet të japin llogari për arritjen e rezultateve në mënyrë të verifikueshme dhe në raport me treguesit SMART.

Komponentët kryesorë që Raportet e Monitorimit dhe Performancës do të vlerësohen për përputhshmërinë me Parimet e Mirëqeverisjes lidhen me komponentët e mëposhtëm:

Qasja analitike e strukturuar bazuar në evidenca dhe konsultim

- Informacioni i dhënë shpjegon kuadrin metodologjik në përputhje me procedurat dhe standartet e sistemit.
- Progresi ndaj secilit qëllim politik dhe objektivi specifik të strategjisë bazuar në tregues si dhe zbatimin e reformave kryesore në sektor është paraqitur qartë.
- Shkalla në të cilën palët kryesore të interesit janë përfshirë në procesin e hartimit të raportit dhe raporti i monitorimit është konsultuar me të gjithë grupet si dhe publikuar në ëëbin respektiv të institucionit (evidencë kryesore është raporti i konsultimit publik për procesin si dhe evidentimi që komentet janë marrë në konsideratë).
- Shkalla e paraqitjes analitike të zhvillimeve të sektorit globalisht ose në rajon.
- Shkalla e paraqitjes analitike të zbatimit të strategjisë me efekte në axhendën e integritimit evropian.
- Shkalla e paraqitjes analitike lidhur me identifikimin e fushës e cila adresohet për përmirësim si dhe efektet në ekzekutimin përgjithshëm të buxhetit.

Progresi i arritur vs qëllimet e politikave, objektivat specifike dhe masat

- Shkalla në të cilën progresi shpreh qartë vlerësimin e arritjeve kryesore duke përdorur treguesit e performancës. Është vlerësuar analiza përmes grafikëve, dashboards, analizës së thelluar dhe vizualisht përmes tabelave). Gjithashtu paraqitet qartë identifikimi i shkallës së performancës.
- Shkalla në të cilën progresi adreson vlerësimin e sfidave, boshllëqeve dhe jo efikasitetit (identifikohet qartë në raportin e monitorimit se cilat fusha (bazuar në qëllimet e politikave / objektivat specifike) tregojnë performancën më të dobët/jo rezultative, vs performancën më të lartë të objektivave, duke përdorur treguesit e rezultateve, përmes grafikëve, dashboards, analizës së thelluar dhe vizualisht përmes tabelave.
- Konkuluzionet dhe rekomandimet janë të bazuara në përputhje me evidencat e raportit dhe japin masa konkrete për korrektim/përmirësim për t'u adresuar në vendimmarrje.

Performanca e kategorizuar sipas standarteve

- Përcaktimi i nivelit të arritjes së objektivit të secilit tregues të performancës është identifikuar. Është kryer mbledhja e të dhënave të disponueshme. Është llogaritur norma e realizimit të treguesit: 1) vlera e synuar, 2) vlera bazë dhe 3) të dhënat për arritjen e synimit.
- Niveli i arritjes së objektivit është përcaktuar. Gjithashtu është llogaritur norma mesatare e zbatimit të të gjithë treguesve të performancës lidhur me çdo objektivi të veçantë. (është kryer hedhja e të dhënave të niveleve të realizimit të çdo treguesi të lidhur me performancën dhe pjesëtimin me numrin e treguesve të performancës)

- Niveli i përcaktimit të shkallës së realizimit të objektivit për një nga katër (4) intervalet e sistemit të performancës është kryer dhe analizuar. Gjithashtu Intervali është përcaktuar në bazë të nivelit të tolerancës. (i.dobët, ii. Mjaftueshëm, iii. Mirë, iv. Shumë mirë, v.Tejkaluar)

Risqet

- Shkalla në të cilën identifikohen risqet në nivel qëllimi politike dhe objektiv specifik në zbatim të Ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- Shkalla në të cilën analizohen risqet në nivel qëllimi politike dhe objektiv specifik.
- Vlerësimi i riskut është kryer në përputhje me kategorizimet i.ulët; ii. mesëm dhe iii.lartë.
- Vlerësimi i mundësisë së ndodhjes së riskut është kryer në përputhje me kategorizimet i.ulët; ii. mesëm dhe iii.lartë.

Analizat financiare

- Shkalla e analizës së kryer lidhur me (i) në buxhetin e përdorur në periudhën e monitorimit, (ii) hendekun e financimit dhe (iii) nevojat e ardhshme.
- Analiza e buxhetit të përdorur është analizuar e lidhur me programet buxhetore (identifikohen saktë numri total i programeve buxhetore) në tre (3) nivele: (i) qëllimi i politikave (ii) objektivi specifik (iii) masat/ produktet si dhe totali për strategjinë.
- Shkalla e analizës financiare është kryer ku janë identifikuar dhe shkaqet e mungesës së fondeve dhe se si ky hendek do të trajtohet në të ardhmen.

Plani i Veprimit

- Plani është zbrëthyer në realizueshmërinë e masave/produkte/aktivitete.
- Janë identifikuar institucionet zbatuese dhe kodet referuese për programet buxhetore.
- Janë identifikuar qartë periudha e realizueshmërisë.
- Institucionet e tjera/bashkëpunuese janë identifikuar.
- Masat/produktet janë të përputhura me produktet e programeve buxhetore (identifikohen qartë programet buxhetore)

1.1.8 Procedura për analizimin e të dhënave për raportin e monitorimit dhe performancës

Analiza e të dhënave është bërë në përputhje me parimet e mirëqeverisjes dhe strukturës vlerësuese për arritjen e performancës në Kryeministri.

Së pari është analizuar zbatimi i masave duke dhënë një rezultat sasior dhe cilësor të realizimit të tyre përkundrejt kryerjes së aktiviteteve respektive të lidhura me to.

Së dyti, është analizuar arritja e vlerës së synuar për këtë periudhë e përcaktuar në treguesit e performancës, duke vlerësuar gjithashtu edhe shkallën e ndikimit të masave të realizuara në arritjen e vlerës së synuar.

Së treti është analizuar realizimi i objektivëve specifike përmes përlllogaritjes së realizimit të treguesve të performancës dhe përqindjes së masave të lidhura me objektivin përkatës të realizuara.

Zbatueshmëria e masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit klasifikohet me vlerat si më poshtë:

E zbatuar: është raportuar statusi “E zbatuar” për ato masa/aktivitete të cilat janë përmbushur.

Pjesërisht e zbatuar/Në proces: është raportuar statusi “Në proces” për ato masa/aktivitete, të cilat në periudhën e raportimit kanë pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijnë të jenë në zbatueshmëri prej tyre.

E pazbatuar: Të pazbatuara janë raportuar ato masa/aktivitete të cilat nuk kanë regjistruar zhvillim për periudhën raportuese si dhe gjithashtu ato masa/aktivitete për të cilat nuk ka pasur progres.

Për përllogaritjen e realizimit të objektivëve specifike sipas arritjes së masave të planifikuara për zbatim në këtë periudhë, është përdorur formula si më poshtë ⁴:

$$NR = \frac{TP\ 1\ NR + TP\ 2\ NR}{2\ TP} \times 100\%$$

Përllogaritja e realizimit të objektivit përkundrejt zbatimit të masave është kryer në bazë të 4 intervaleve të sistemit të performancës si në tabelën dhe kodin e ngjyrave më poshtë:⁵

Kategoria	Niveli i Tolerancës	Pikët (110)
Dobët	Nga 0 deri në 30 për qind e masave të realizuara	30
Mjaftueshëm	Nga 31 në 50 për qind e masave të realizuara	20
Mirë	Nga 51 në 85 për qind e masave të realizuara	35
Shumë mirë	Nga 86 në 110 për qind e masave të realizuara	25
Tejkaluar	111 dhe më lart	N/A

Niveli tjetër i analizës është realizuar sipas qëllimeve të politikës. Bazuar në të dhënat e realizueshmërisë për secilin nivel analitik (masa, tregues performance, objektiv specifik) është vlerësuar secili nga katër qëllimet e politikave: 1. Funkionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, eficientë dhe llogaridhënie; 2. Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane; 3. Një Sistem i Drejtësisë Penale i mbështetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit; 4. Koordinimi, manaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjithë institucione e sektorit.

⁴ Formula e përllogaritjes është marrë nga guida metodologjike e hartimit të raporteve të monitorimit të dokumenteve strategjike IPSIS.

⁵ Vlerësim është realizuar në përputhje me Guidën Metodologjike “Struktura e raporteve të monitorimit për dokumentet strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale për agjendën e mirëqeverisjes”.

Matrica e Riskut

Në raportin e monitorimit vlerësohet identifikim i risqeve me qëllim identifikimin e hapave që do të duhen të ndiqen për t'u adresuar në kuadër të implementimit të objektivëve të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit.

Vlerësimi i riskut është kryer në përputhje me tabelën më poshtë⁶:

Mundësia	E lartë	3	6	9
	E mesme	2	5	8
	E ulët	1	4	7
	E ulët		E mesme	E lartë
	Ndikimi			

1.1.9 Konsultimi publik i raportit të monitorimit dhe performancës

Në përputhje me kriteret ligjore për konsultimin publik, pas hartimit të draft raportit, Ministria e Drejtësisë e dërgoi në datën 11.05.2022 dokumentin për konsultim të parë pranë institucioneve raportuese, si dhe me datë 24.05.2022 vijoi me konsultimin e draftit të dytë dhe publikoi draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve, në faqen e internetit www.drejtësia.gov.al, në menu prioritete/strategjia ndërsektoriale/strategjia ndërsektoriale kundër korrupsionit. Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kreu reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft raportin e monitorimit dhe vijoi me zhvillimin e një takimi të dedikuar datë 10 qershor 2022, në kuadër të diskutimit të analizës së kryer, gjetjeve të raportit, vlerësimit të qëllimeve të politikës në prezencë të të gjithë institucioneve zbatuese dhe raportuese të planit të veprimit.

Raporti i konsultimit publik të raportit të monitorimit publikohet gjithashtu në faqen e internetit të ministrisë, www.drejtësia.gov.al.

⁶ Analiza dhe vlerësimi i riskut është kryer referuar Guidës Metodologjike për hartimin e raporteve të monitorimit për Agjendën e Mirëqeverisjes.

PROGRESI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT

Strategjia Ndërsektorale kundër Korrupsionit 2015-2023 ka si synim arritjen e objektivave madhorë të kësaj strategjie nëpërmjet realizimit të masave konkrete antikorrupsion, me qëllim zhvillimin e një shoqërie në të cilën ekziston një sistem i përgjegjshëm dhe efikas kundër korrupsionit, i cili është në gjendje për të përfituar rezultate të prekshme dhe të tregojë tendencë drejt eliminimit maksimal të kërcënimeve të korrupsionit, si dhe vullnetit për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin. Për të monitoruar ecurinë e SNKK 2015-2023, është hartuar raporti periodik i rradhës, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit 2020– 2023, i cili mbulon periudhën *1 janar deri më 31 mars 2022*.

Masa dhe aktivite të implementuara me sukses në periudhën përkatëse

Qëllimet e politikave (qasjet) dhe objektivat specifikë bëhen të realizueshëm nëpërmjet masave dhe aktiviteteve të parashikuara (produkte), të parashikuara për zbatim, nga institucionet përgjegjëse edhe bashkëpunëtore të Strategjisë dhe të Planit të Veprimit.

SNKK ka **tre qëllime kryesore politikash** (qasje) përmes të cilave synon të përmbushë vizionin e saj dhe 18 objektiva specifikë.

Duke aplikuar të njëjtën formulë⁷ të vlerësimit të shkallës së realizimit të objektivave – duke mbledhur realizueshmërinë në përqindjes të qëllimeve të politikës dhe pjesuar me numrin e tyre – realizueshmëria e qëllimit strategjik ndërinstucional kundër korrupsionit është 78.25%.

Qasja Parandaluese (A)	86.50%
Qasja Ndëshkuese (B)	81.6%
Qasja Ndërgjegjësuere (C)	66.66%

Vërehet se të tre Qëllimet e Politikës I, II e III (Qasja Parandaluese A-B-C) paraqesin trende pozitive.

Krahasuar me monitorimin e kryer për vitin 2021 Qasja Parandaluese (A) shfaq një trend rritës me 28.17% më shumë, për këtë 3M1 2022, Qasja Ndëshkuese (B) shfaq trend rritës me 35% më shumë dhe Qasja Ndërgjegjësuere (C) shfaq trend rritës me 11.41% më shumë.

Konkretisht sipas 18 objektivave specifikë, niveli i realizueshmërisë sipas masave dhe aktiviteteve për zbatim për periudhën e monitorimit, është si më poshtë:

⁷ Shiko footnote 3.

Qasja A	Realizueshmëria
A.1	100%
A.2	75%
A.3	100%
A.4	75%
A.5	100%
A.6	60%
A.7	66.6%
A.8	100%
A.9	100%
A.10	100%
A.11	75%

Qasja B	Realizueshmëria
B.1	100%
B.2	70%
B.3	- ⁸
B.4	75%

Qasja C	Realizueshmëria
C.1	100%
C.2	100%
C.3	0%


Bazuar te niveli i realizueshmërisë së 18 objektivave specifike, kemi trend rritës zbatimi në masat e 12 objektivave, konkretisht A1, A2, A4, A5, A6, A7, A8, A9, A11, B1, B2 dhe C1; vihet re trend zbritës në masat e 1 objektivi, konkretisht B4, dhe të pandryshuara ngelen masat e 4 objektivave, konkretisht A3, A10, C2 e C3. Objektivi B3 është i parashikuar për zbatim në tremujorët e tjerë të 2022. Ky vlerësim është bërë duke marrë në konsideratë nivelin e realizueshmërisë (në përqindje) të objektivave në raportin vjetor 2021 përkundrejt realizueshmërisë së masave dhe aktiviteteve për periudhën në monitorim, janar - mars 2022.

Plani i Veprimit 2020 – 2023, për vitin 2022 parashikon zbatimin e 119 aktivitete e 69 masa, të shpërndara përkatësisht në 64 aktivitete e 37 masa për Qëllimin e Politikës I (qasjen parandaluese A), 32 aktivitete e 22 masa për Qëllimin e Politikës II (qasjen ndëshkuese B) dhe 23 aktivitete e 10 masa për Qëllimin e Politikës III (qasjen ndërgjegjësuere C).

Për këtë periudhë monitorimi, *janar - mars 2022*, rezulton se janë parashikuar për zbatim 108 aktivitete dhe 58 masa, nga të cilat: 103 aktivitete e 59 masa janë vijuese/në vazhdim nga periudha e vitit të mëparshëm (2020), 5 aktivitete dhe 6 masa janë të reja/që kanë filluar zbatimin në këtë tre-mujor të parë të vitit 2022.

⁸ Për këtë objektivi, nuk ka masa dhe aktivitete për zbatim për 3M1 2022.


Qëllimet e Politikës (Qasja)	Aktivitetet dhe Masat	Aktivitete dhe Masa, janar – mars 2022			
		Aktivitete dhe Masa të parashikuara për vitin 2022	Aktivitete dhe Masa të parashikuara për 3M1 2022	Aktivitete dhe Masa në vijim ⁹	Aktivitete dhe Masa të reja ¹⁰
Parandaluese	Masa	37	29	27	2
	Aktivitete	64	58	54	4
Ndëshkuese	Masa	22	20	19	1
	Aktivitete	32	29	25	4
Ndërgjegjësuere	Masa	10	9	8	1
	Aktivitete	23	21	16	5
Total	Masa	69	58	54	4
	Aktivitete	119	108	95	13



Statusi i masave dhe aktiviteteve që kanë realizuar qëllimet e politikave (qasjet):

⁹ Aktivitete dhe masa që e kanë nisur zbatimin në periudhat e mëparshme të vitit 2020 dhe vazhdojnë zbatimin e tyre dhe në këtë tremujor të 2022.

¹⁰ Aktivitete dhe masa që e nisin zbatimin e tyre në këtë tremujor të 2022.



Progresi total i arritur në kuadër të përmbushjes së tre qëllimeve të politikës (qasjeve) të strategjisë lidhur me statusin e zbatimit të aktiviteteve dhe masave është si më poshtë:

- 34 masa e 64 aktivitete të zbatuara;
- 15 masa e 11 aktivitete ende në proces zbatimi;
- 9 masa e 33 aktivitete të pazbatuara (përfshirë edhe masat e paraportuara në këtë fazë të procesit të monitorimit).

Përsa më sipër, nga **34 masa e 64 aktivitete të zbatuara** për tremujorin e parë të vitit 2022, konkretisht 15 masa/37 aktivitete i përkasin qasjes parandaluese (A), 12 masa/16 aktivitete i përkasin qasjes ndëshkuese (B), si dhe 7 masa/12 aktivitete i përkasin qasjes ndërgjegjësuese (C).


Nga **15 masa e 11 aktivitete të cilat janë ende në proces zbatimi** për tremujorin e parë të vitit 2022, konkretisht 10 masa/8 aktivitete i përkasin qasjes parandaluese (A), 5 masa/3 aktivitete i përkasin qasjes ndëshkuese (B), si dhe 0 masa/0 aktivitete i përkasin qasjes ndërgjegjësuese (C).

Nga **9 masa e 33 aktivitete të pazbatuara** për tremujorin e parë të vitit 2022, konkretisht 4 masa/14 aktivitete i përkasin qasjes parandaluese (A), 3 masa/10 aktivitete i përkasin qasjes ndëshkuese (B), si dhe 2 masa/9 aktivitete i përkasin qasjes ndërgjegjësuese (C).

Statusi i aktiviteteve që kanë realizuar qëllimet e politikave (qasjet):

Nga totali prej 108 aktiviteteve të parashikuara për zbatim në *janar – mars 2022*, 58 prej tyre i përkasin Qasjes A, 29 aktivitete i përkasin Qasjes B, si dhe 21 aktivitete Qasjes C.

Statusi i aktiviteteve në Planin e Veprimit 2020 - 2023, për periudhën janar-mars 2022				
Progresi i aktiviteteve	Qasja A (Parandaluese)	Qasja B (Ndëshkuese)	Qasja C (Ndërgjegjësuese)	Totali i Qasjeve
Zbatuar	37	16	12	64
Në proces	8	3	0	11
Pazbatuar	14	10	9	33
Totali	58	29	21	108




Rezulton se nga 108 aktivitete të parashikuara për periudhën *janar - mars 2022*, aktivitete në vijim dhe të reja, statusi i tyre për të 3 qasjet është raportuar si më poshtë:

- 64 aktivitete të zbatuara;
- 11 aktivitete janë ende në proces zbatimi;
- 33 aktivitete të pazbatuara (paraportuara) nga institucioni përgjegjës (nga ku mund të përmendim A.2.1.2; A.2.2.2; A.2.3.2; A.4.4.1; A.4.4.2; A.4.4.3; A.6.6.1; A.6.1.2; A.7.1.3; A.7.1.4; A.7.3.2; A.7.3.4; B.1.2.2; B.1.4.1; B.1.11.1; B.2.1.1; B.2.3.1; B.2.3.2; B.2.3.3; B.2.3.4; B.2.4.2; B.2.6.1; B.4.1.2; C.3.1.1; C.3.1.2; C.3.1.3; C.3.1.4; C.3.1.5; C.3.1.6; C.3.2.1; C.3.2.2 dhe C.3.2.3).

Statusi i masave që kanë realizuar qëllimet e politikave (qasjet):

Nga totali prej 58 masash të parashikuara për zbatim në *janar – mars 2022*, 29 prej tyre i përkasin Qasjes A, 20 masa i përkasin Qasjes B, si dhe 9 masa Qasjes C.

Statusi i masave në Planin e Veprimit 2020 - 2023 për periudhën janar-mars 2022				
Progresi i masave	Qasja A (Parandaluese)	Qasja B (Ndëshkuese)	Qasja C (Ndërgjegjësuere)	Totali i Qasjeve
Zbatuar	15	12	7	34
Në proces	10	5	0	15
Pazbatuar	4	3	2	9
Totali	29	20	9	58



Rezulton se nga 58 masa të parashikuara për periudhën *janar - mars 2022*, masa në vijim dhe të reja, statusi i tyre për të 3 qasjet është raportuar si më poshtë:

- 34 masa të zbatuara;
- 15 masa janë ende në proces zbatimi;
- 9 masa të pazbatuara (paraportuara) nga institucioni përgjegjës (nga ku mund të përmendim A. 4.2, A. 6.1, B. 1.11, B.2.1, B. 2.3, B.2.4, B. 2.6, C. 3.1 dhe C. 3.2).

Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur masat dhe aktivitetet:

Mbështetur në informacionin mbi raportimin dhe vlerësimin e aktiviteteve dhe masave të zbatuara¹¹, realizimi i objektivëve për *janar - mars 2022*, është si më poshtë.

Dobët - 1 objektiva (objektivi: C.3)

Mirë - 6 objektiva (objektivi: A.2, A4; A6; A7; A.11 dhe B4)

Shumë mirë - 10 objektiva (objektivi: A1; A.3; A5; A.8; A.9; A.10; B1; B2; C.1 dhe C.2)

Tejkaluar – N/A objektiva.

Histori sukcesi (përmes masave prioritare)

Ecuria e arritur në kuadër të përmbushjes së aktiviteteve dhe masave të parashikuara, për periudhën e monitorimit, *janar – mars 2022*, në zbatim të Planit të Veprimit 2020-2023, të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015- 2023, është si më poshtë vijon:

- Autoritetet publike vijojë të pajisen me e-regjistër të kërkesave dhe ankesave në zbatim të të drejtës së informimit, duke plotësuar vlerën e synuar vjetore, prej 25 autoritetesh për vitin 2022.
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka vijuar me shtimin e shërbimeve elektronike dhe përmirësimin e shërbimeve ekzistuese në portalin unik qeveritar e-Albania, duke shtuar shërbimet elektronike me një numër total prej 1 225.
- Vijojnë bashkëpunimet e ndërsjellta PSH-SHCBA me qëllim trajtimin e denoncimeve kundër korrupsionit. Është finalizuar 1 rast i përbashkët i PSH me SHÇBA(AMP) dhe SPAK. Në përfundim të këtij hetimi, gjykata e posaçme vendosi masat e sigurisë për 28 punonjës policie dhe 2 shtetas.
- Gjatë kësaj periudhe raportimi, për veprën penale të korrupsionit, Policia e Shetit ka dërguar 34 subjekte për procedime penale.
- SHÇBA (AMP) ka marrë 1114 telefonata, nga të cilat 566 telefonata kanë qenë brenda objektit të punës së SHÇBA-së dhe nëpërmjet strukturave të Shërbimit në nivel qendror dhe vendor si dhe strukturave vendore të policisë, ku është kontaktuar menjëherë telefonuesi duke i dhënë zgjidhje problemit të ngritur. 167 telefonata kanë qenë jashtë fushës së veprimtarisë së SHÇBA-së dhe shtetasve u është dhënë informacioni i kërkuar dhe janë adresuar pranë strukturës përkatëse ku duhet të depozitohen ankesën e tyre. 381 telefonata kanë qenë me objekt informacion në lidhje me veprimtarinë e SHÇBA-së. Ka vijuar gjithashtu puna për administrimin e ankesave, sipas statistikave të paraqitura në aktivitetin A.4.5.1.

¹¹ Objektivi B3, nuk është vlerësuar sepse nuk ka masa dhe aktiviteteve për zbatim direkt në 3M1 2022.

- Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion ka paraqitur/referuar pranë organit të prokurorisë 7 kallëzime penale, për 19 persona (nëpunës/punonjës) + persona të tjerë të paidentifikuar; janë 11 raporte përfundimtare hetimi të përfunduara për hetimet administrative të zhvilluara pranë institucioneve të ndryshme të rrjetit, ku janë propozuar 64 masa disiplinore, për 64 persona (punojës/nëpunës), të institucioneve, subjekt hetimi.
- Gjatë periudhës janar-mars 2022, janë miratuar Planet e Integritetit për 5 njësi të vetëqeverisjes vendore, me anë të vendimeve të Këshillave Bashkiakë, konkretisht Bashkia Berat, Bulqizë, Belsh, Përmet dhe Pogradec.
- Policia e Shtetit ka shkëmbyer në total 104 praktika praktika me Interpolin, 77 praktika me Europolin, 32 praktika me Departamentin e Mardhënies Ndërkombëtare dhe 15 praktika me rrjetin CARIN.
- Ministria e Drejtësisë ka dhënë propozime konkrete në kuadër të aktiviteteve që do të zhvillohen gjatë vitit 2022, në kuadër të vitit Tirana Kryeqyteti Evropian i të Rinjve 2022 (Tirana European Youth Capital 2022). Aktivitete kulturore, edukative, sportive, kërkimore të ndërthurur me ekspertizë juridike dhe institucionale të fushës antikorrupsion janë planifikuar të zhvillohen gjatë gjithë vitit 2022.
- Ministria e Drejtësisë ka publikuar udhëzuesin “Antikorrupsioni”, një instrument ndërgjegjësimi dhe informimi i luftës kundër korrupsionit i përgatitur në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, që përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për çdo qytetar shqiptar por edhe të huaj që jeton dhe punon në Shqipëri. Botimi gjendet i publikuar në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë, në linkun <https://drejtesia.gov.al/viti-2022/>

EKZEKUTIMI I BUXHETIT

Sipas SNKK, financimi i Planit të Veprimit realizohet nga dy burime kryesore: buxheti i shtetit dhe mbështetja financiare e partnerëve ndërkombëtarë.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të aktiviteteve e masave të Planit të Veprimit 2020 - 2023, edhe për këtë periudhë institucioneve përgjegjëse u është kërkuar të raportojnë mbi buxhetin e përdorur në bazë të performancës së kryer.

Buxheti i përdorur sipas objektivave dhe burimi konkret i financimit është si vijon:

A1: Nuk raportohen të dhëna.

A2: 3.379.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A3: Nuk raportohen të dhëna.

A4: 10.785.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A5: 3.233.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A6: Nuk raportohen të dhëna.

A7: 1.541.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A8: 40.910.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A9: 12.455.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A10: 178.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A11: Nuk raportohen të dhëna.

B1: 58.107.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit dhe pjesa tjetër nga donatorë: 7.000.000

B2: Nuk raportohen të dhëna.

B3: Nuk matet për këtë periudhë raportimi

C1: 106.377.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

C3: Nuk raportohen të dhëna.

Edhe për këtë raport monitorimi, rezulton se për një pjesë të aktiviteteve të kryera gjatë këtij viti, zbatimi, kostot vijojnë të raportohen në “kosto administrative”, dhe mungon një vlerë konkrete e tyre. Në total, janë 33 aktivitete që raportohen të jenë kryer me “kosto administrative” dhe 42 aktivitete me 0 (zero) kosto/pa raportuar.

Buxheti i përdorur sipas qëllimeve të politikës/Qasjeve A-B-C, është:

Qëllimi i politikës 1 (qasja parandaluese- A)

72.481.000 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit

Qëllimi i politikës 2 (qasja ndëshkuese - B)

58.107 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit dhe 7.000.000 mbuluar nga donatorë.

Qëllimi i politikës 3 (qasja ndërgjegjësuere - C)

106.377.000 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit

Totali i buxhetit të përdorur për këtë periudhë është:

- *Financimi nga buxheti i shtetit është në shumën 236.965.000 lekë.*

- *Financimi nga donatorët është në shumën 7.000.000 lekë.*

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Mbështetur në rezultatet e monitorimit të kryer, rezulton se për periudhën *1 janar – 31 mars 2022*, fushat që kanë treguar performancë por edhe shoqëruar nga problematika janë aktivitete dhe masa

të shpërndara në të gjithë objektivet specifike në të tre qëllimet e politikës (qasjet) e SNKK, parandalim (A) – ndëshkim (B) – ndërjegjësim (C).

Institucionet kanë dëshmuar vazhdimësi, përpjekje dhe vullnet për të zbatuar masat, kryer aktivitetet në funksion të tyre, në përputhje me buxhetet e parashikuara në planin e veprimit, mbështetjet e partnerëve ndërkombëtarë dhe vendas; si dhe janë mbështetur në burimet e tyre njerëzore dhe kapacitetet teknike profesionale të brendshme.

Organet publike dhe agjencitë e zbatimit të ligjit po vijojnë punën me të dhëna solide, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar si dhe po dëshmojnë një ecuri proporcionale në funksion të targetit vjetor që do duhet të arrihet në fund të vitit 2022.

Rekomandime

Në përfundim të këtij raporti, rekomandimet për vijueshmërinë e zbatimit të planit të veprimit janë:

- të fillojë kryerja e aktiviteteve dhe masave për atë objektive të strategjisë, që rezultojnë në nivelin e zbatimit dobët (*nga 0 deri në 30 për qind e masave të zbatuara*), edhe për shkak të mungesës së raportimit, përkatësisht objektivi C3.
- në funksion të përmirësimit të nivelit të përgjithshëm të raportit të monitorimit, sugjerohet të shmanget raportimi i njëjtë për aktivitete të ndryshme, të cilat profilizohen sipas masave përkatëse.
- raportimi mbi buxhetin e shpenzuar do duhet të kryhet për çdo aktivitet e më pas të mblidhen shumatat në mënyrë kumulative për secilën masë përkatëse të Planit të Veprimit 2020 – 2023.
- të shqyrtohen me kujdes ato aktivitete të Planit të Veprimit të cilat rezultojnë me një ecuri negative në mënyrë të përsëritur përgjatë raporteve të monitorimit.
- të krijohen kushtet për të rritur nivelin e performances së institucioneve raportuese në nivel qëndror dhe vendosur, duke mundësuar adresimin e risqeve që konsiderohen më evidente.
- të jepet evidencë e plotë (psh me numër akti apo me linkun e publikimit), për të gjitha ato masa apo aktivitete, të cilat raportohen se kanë një nivel të lartë realizueshmërie.
- Të rritet bashkëpunimi insitucional, sidomos aty ku parashikohet shprehimisht se niveli i realizimit varet pikërisht nga produktet e përbashkëta.

Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit

Rezulton se ndër objektivet me mungesë të plotë realizueshmërie për periudhën raportuese (edhe për arsye të mungesës së raportimit), *janar – mars 2022*, është C3.

Në këtë raport ka gjithashtu një mungesë informacioni për buxhetin e një sërë masave dhe aktiviteteve si dhe mungon një vlerësim i nevojave konkrete, për fushat që kanë riskun më të lartë.

Vlerësimi i riskut duke përdorur masat dhe aktivitetet

Në këtë raport monitorimi, *janar - mars 2022*, ndër risqet që u evidentuan kryesisht, janë të lidhura me kapacitetet teknike, institucionale, proceset e punës, asistencë teknike, bashkëpunimi institucional dhe mjedisi rregullator.

- Objektivet të cilat paraqesin një nivel të lartë risku janë objektivat A7, B.2 dhe C3.

Objektivi A2 ka një nivel të lartë risku në përmirësimin e procesit të planifikimit nëpërmjet publikimit paraprak të procedurave të prokurimit që mund të vijnë si pasojë e mungesës së forcimit të kapaciteteve dhe njohurive të stafit.

Objektivi C3 gjithashtu ka një nivel të lartë risku për shkak të rreziqeve të nevojës së shtuar në avancimin drejt thirrjeve të hapura për propozime specifike në luftën kundër korrupsionit, si dhe forcimin e bashkëpunimit të PSH me OSHC-të, për gjenerimin e raporteve vlerësuese mbi hetimin e rasteve të korrupsionit.

Në përfundim, të gjitha institucionet zbatuese të këtij plani veprimi, duhet të marrin në konsideratë këtë analizë dhe të shtojnë përpjekjet për zbatimin e masave dhe aktiviteteve duke pasur si prioritet arritjen e vlerave të treguesve të performancës për të arritur qëllimin e objektivëve specifike. Në raportin e monitorimit, janar – qershor 2022, do të ketë një analizë të shtuar të treguesve të performancës¹².

Hapat e rradhës

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën *janar-mars 2022*, të gjetjeve që ky raport na ofron, të të dhënave analitike që institucionet kanë raportuar dhe të analizës së kryer, adresohen të ndërmerren këto hapa në vijim:

A2: Rritja e transparencës në planifikimin, detajimin, menaxhimin dhe kontrollin e fondeve buxhetore:

Të vijohet me forcimin e njohurive, zhvillimin e trajnimeve dhe zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale të stafit teknikë të institucionit.

¹² Në baza 6 mujore maten 6 tregues, ata janë: A.1.a; A.2.a; A.2.b; A.2.c; A.7.b dhe A.10.

A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit:

Institucionet publike do duhet të monitojnë në mënyrë proaktive dhe të vazhdueshme median e shkruar dhe elektronike për të marrë dijeni dhe trajtuar në kohë ankesat e denoncuar publikisht për krimin e korrupsionit dhe kjo mund të arrihe edhe duke marrë aksesin në platformën shqiperiaqeduam.al.

A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike:

KQZ të zhvillojë rrisë transparencën dhe publikimin e shtuar të akteve dhe kontrolleve të kryera në referencë me praktikatat e vendeve më të zhvilluara në këtë drejtim.

A7: Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut:

Ka nevojë të kemi rezultate më të dukshme në funksion të kapaciteteve inspektuese financiare, të cilat duhen të orientohen drejt çështjeve të mashtrimit dhe korrupsionit. Të dërgohet raportimi i kërkuar për të mundësuar vlerësimin dhe matjen e objektivit.

A9: Forcimi i integritetit të nëpunësve publik:

Të vijojë procesi i hartimit të planeve të integritetit në 7 ministritë e tjera të linjës.

A.11 Adaptimi i politikave antikorruption në nivelin e qeverisjes vendore:

Të vijojë procesi dhe miratimi i PI në njësitë e mbetura të vetëqeverisjes vendore.

B1: Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit:

Të forcohen dhe përmirësohen komunikimi, informimi dhe bashkëpunimi ndërinsitucional midis organeve ligjzbatuese. Ka ende nevojë për të forcuar kapacitetet e këtyre organeve në drejtim të sekuestrimeve të pasurive që lidhen me korrupsionin dhe të raportohen të dhënat e tyre statistikore.

Të dërgohet raportimi i kërkuar për të mundësuar vlerësimin dhe matjen e objektivit.

B2: Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndërshkrimin penal të korrupsionit:

Të vijojë rritja e aksesit të mëtejshëm në bazat e të dhënave dhe përdorimi efektiv i tyre për kryerjen e hetimeve, nëpërmjet ndërlidhjes së sistemeve, përkatësisht të: Regjistri i pronarëve përfitues, Regjistrin Qendror i llogarive bankare, Bazën e të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave; Bazën e të dhënave në Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në vartësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Bazën e të dhënave në Sistemin Elektronik të çështjeve të Përmbarrimit Gjyqësor dhe Bazën e të dhënave të Shërbimit/Regjistrin Noterial Shqiptar në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë.

B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit:

Të vijohet me kryerjen e trajnimeve të përbashkëta, forcimin e kapaciteteve profesionale dhe rritjen e bashkëpunimit me institucionet homologe ndërkombëtare si dhe me ngritjen e skuadrave të përbashkëta hetimore për hetimin e korrupsionit.

Të dërgohet raportimi i kërkuar i plotë.

C2: Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit:

Platforma e bashkëqeverisjes do duhet të ketë një ndarje të saktë midis numrit total të denoncimeve të ardhura në platformë/numrit të denoncimeve që lidhen me veprime korruptive dhe rasteve të adresuara pranë Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë për secilën periudhë raportimi.

C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile:

Të sigurohet efektiviteti i thirrjeve të hapura për propozime specifike në luftën kundër korrupsionit, të financuara nga AMSHC si dhe të merren masat për bashkëpunimin me Policinë e Shtetit për gjenerimin e raporteve vlerësuese.

DRAFT